

FORMULARI 2- VENDIM PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO- QEVERITARE NË FUSHËN E KULTURËS

KOMUNA E DRAGASHIT



Në bazë të nenit 58, ligjit për Vetqeverisje Lokale 03/L-40, dhe nenit 12 të rregullores mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve 04/2017, Kryetari i Komunës, *nxjerr këtë:*

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte të organizatave jo-qeveritare në fushën e sportit, rinisë dhe turizmit.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rinë dhe Sport, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85009/0820,

II

1. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshin:
 1. Teksti i thirrjes publike
 2. Udhëzimet për aplikantët
 3. Formularët e aplikimit
 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
 4. Forma e deklaramit të konfliktit të interesit
 5. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
 6. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
 7. Deklerata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (<https://kk.rks-gov.net/dragash/category/shpalljet/thirrje-per-propozime/?page=2021>)

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OIQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria Për Kulturë Rini dhe Sport.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Emri i plotë dhe pozita

Shaban Shabani –Kryetar




Data: 16.07.2021

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash
02 Nr. Bë. 400/01-14227/21
16 07 21
Dragash - Dragash